

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Adresa: Rruga Ismail Qemali nr 27, Pallati Fratari - Kati V, Tiranë.

Tel: + 355 4 257603/257 606

Email:

aam@albmail.com

Faqja e Internetit

www.aam-al.com

Botuar në Prill 2003, Tiranë- Shqipëri.

Dizenjimi i kapakut

Eda Ilirjani

Kopje të këtij manuali mund t'i gjeni pranë zyrave të SHBSH-së.


Logot AAM KOMPAS

KOMPAS "Komunitet, Pushtet, Administratë së Bashku", është emri zyrtar i Programit të Qeverisë Hollandeze në Shqipëri që është zbatuar nga Maj 2000 deri në Prill 2003.

Ky manual është një botim i publikuar në bazë të eksperiencave të programit KOMPAS gjatë punës për zhvillimin e projekteve demonstrative me bashkitë partnere. Tematika e këtyre projekteve demonstrative përkon me ato fusha të politikës bashkiake, që janë parë me përparësi nga kryebashkiakët përkatës, gjatë kohës së zbatimit të Programit KOMPAS.

Ky manual është përgatitur për t'i shërbyer Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë në përpjekjet e saj për të ndihmuar ato bashki që kanë nevojë për të ndërmarrë projekte të njëjta apo të ngjashme me atë të përshkruar në këtë manual.

Përpunimi i një plani urban në bashkitë e Shqipërisë



Datë: 05 janar 2003

Përmbajtja

01	Hyrje	03
02	Organizimi	05
03	Përpunimi i një vizioni shoqëror, ekonomik dhe urban	08
04	Faza e inventarizimit	12
05	Pjesëmarrja dhe komunikimi i qytetarëve	14
06	Pjesëmarrja Nismë-marëse	16
07	Projekti paraprak / Skicëide projekti	17
08	Pjesëmarrja ndërvepruese	18
09	Hartimi përfundimtar dhe përshkrimi i rregullave	19
10	Pjesëmarrja formale (ligjore)	20
11	Procedura e miratimit	21
12	Përmbledhje	23
	Shtojca A - Metoda pyetësore "Loja e monedhës"	26
	Shtojca B - Plani urban për qytetin e Peshkopisë	31

01 Hyrje

Qeveria shqiptare nisi një proces demokratizimi. Për llogari të kësaj nisme u konceptua një projekt i quajtur KOMPAS, një vazhdim logjik i projektit Forcimi i Qeverisë Vendore dhe i Pjesëmarrjes Qytetare (FOVPO). Projekti **COM**muniteti, Pushtet, **Administratë Së** bashku (KOMPAS) përshkruan tre objektivat imediate vijuese:

1. Dhënie mbështetjeje për Qeverinë shqiptare për vënien në jetë të politikave të decentralizimit dhe përmirësim i aftësive për të ndërmarrë dhe lehtësuar qeverisjen vendore demokratike dhe me pjesëmarrje;
2. Forcim institucional në një numër qeverish vendore për çështjet e qeverisjes vendore të shëndetshme, demokratike dhe me pjesëmarrje;
3. Hartim dhe ndërmarrje e një ndërgjegjësimi publik për qeverisjen vendore demokratike dhe me pjesëmarrje.

Për llogari të programit që duhet të udhëheqë këtë proces Sektori Ndërkombëtar i Organizatës së Bashkive Hollandeze (VNGI) ka piketuar disa qytete shqiptare që do të marrin pjesë në projekte të ndryshme.

Një prej këtyre qyteteve është Peshkopia, kryeqendra e rrethit të Dibrës, në pjesën verilindore të Shqipërisë. Mes tetorit 2001 dhe dhjetorit 2002 në Peshkopi u vu në jetë një projekt planifikimi urban. Projekti u drejtua nga z. John Hermes, drejtues i departamentit të planifikimit urban në Zeist (Hollandë). Ai u mbështet dhe u ndihmua nga z. Flamur Kuçi, eksperti shqiptar nga Co-plan.

Hartimi i një plani urban për një bashki është mjaft kompleks për shkak të interesave të larmishme dhe të ndryshme të qytetarëve, këshilltarëve, nëpunësve civilë, drejtuesve, politikanëve dhe në tërësi shtresave social-ekonomike.

Për shkak të objektivave të projektit KOMPAS të dy ekspertët e vizituan Peshkopinë disa herë në këtë periudhë gjatë së cilës ata trainuan stafin vendor të bashkisë si dhe të gjithë organizmat e projektit.

Ata organizuan pjesëmarrjen e qytetarëve dhe kryen një plan urban për qytetin me pjesëmarrjen e popullatës së Peshkopisë.

I tërë procesi i planifikimit u lehtësua nga organizata KOMPAS në Tiranë.

Në këtë manual përshkruhet se si u organizua dhe u administrua projekti në Peshkopi.
Procesi i përmbushjes mund të shihet si një projekt për bashkitë e tjera të Shqipërisë.

02 Organizimi

Është mjaft e pëlqyeshme të menaxhosh procesin e hartimit të një projekti planifikimi urban me anë të një organizmi projekti. Anëtarët e strukturës së projektit lypset të kujdesen vetëm për projektin.

Përgjegjësitë e projektit mund të ndahen nga detyrat e përditshme.


Është e udhës që struktura të ndahet në tre nivele:

1. Niveli i vendim-marrjes
2. Niveli i administrimit
3. Niveli i projektimit

Kjo ndarje mund të përkthehet si vijon:


1. Bordi i Qeverisë / Kryetari i Bashkisë në emër të Këshillit Bashkiak
 2. Grupi Drejtues
 3. Grupi i Projektit i mbështetur nga nëngrupe (sipas përmbajtjes)
- Pamja poshtë tregon një shembull të përgjithshëm të një strukture projekti në të cilën vihet në jetë pjesëmarrja qytetare (shih po ashtu kapitullin 5).

Lypset të bëhen marrëveshje mes menaxhuesit të projektit dhe Kryetarit të Bashkisë në lidhje me mënyrën e komunikimit dhe vendim-marrjes në stadi të ndryshme të projektit.



Skema e ardhshme tregon pozicionin e grupeve të ndryshme të strukturës së projektit.

Në këtë skemë vijat e pandërprera tregojnë për marrëdhënie të drejtpërdrejta me grupe të tjera dhe vijat e ndërprera tregojnë strukturën e komunikimit me njëri-tjetrin. Shigjetat blu tregojnë që një grup përfaqësohet drejtpërdrejt në grupin tjetër nga një apo më shumë anëtarë.



Menaxheri i projektit parapëlqehet të jetë i pavarur por ky mund të jetë edhe drejtuesi i zyrës bashkiake për planifikimin urban. Nëse ky funksionar nuk është i aftë ta bëjë këtë punë siç duhet për shkak të mungesës së kompetencave ose zënies me punë gjetiu, këshillohet caktimi i një menaxheri të jashtëm projekti që është i aftë të shpenzojë kohë të mjaftueshme për projektin.

Grupi Drejtues përbëhet nga:

- Kryetari i bashkisë që është kreu
- Kryetari i këshillit bashkiak si lidhje mes këshillit bashkiak dhe strukturës së projektit
- Një anëtar i këshillit bashkiak që përfaqëson një parti politike të ndryshme nga ajo e kreut të këshillit bashkiak
- Menaxhuesi i projektit

Grupi i Projektit përbëhet nga:

- Kreu i zyrës së planifikimit urban në bashki (kryetari)
- Eksperti i bashkisë për planifikimin urban
- Eksperti i bashkisë për shoqërinë civile
- Eksperti i bashkisë për marrëdhëniet publike dhe informacionin
- Tre anëtarë të grupit të pjesëmarrjes
- Menaxhuesi i projektit

Nëngrupet përbëhen nga lloj-lloj ekspertësh që rekrutohen nga stafi i bashkisë dhe departamentet e bashkisë dhe që, nëse nevojitet, mbështeten nga specialistë të jashtëm.

Grupi i Pjesëmarrjes (qytetare) duhet të ketë – nëpërmjet anëtarëve të tij – lidhje të drejtpërdrejta me vendasit dhe institucionet vendore. Ndaj, është e rëndësishme që GPQ të jetë një përfaqësim i mirë i popullatës dhe të përbëhet nga anëtarë me përvoja dhe njohuri të ndryshme.

Në çdo rast preferohet ose nevojitet që anëtarët e grupit të kenë këto njohuri vijuese:

- ekonomi
- legjislacion
- zhvillim shoqëror
- shoqëria civile dhe çështjet e rinisë
- teknikat
- zhvillim mjedisor dhe i qëndrueshëm

03 Përpunimi i një vizioni shoqëror, ekonomik, dhe urban

Përse duhet një vizion?

Hartimi i një vizioni është si të bësh një udhëtim emocionues dhe ngashnjyes.

Përse duhet t'i futen një rrugë të tillë anëtarët e qeverisë vendore?

Përgjigjja është sepse një vizion afatmesëm dhe afatgjatë:

- udhëheq rrugën për një politikë bashkiake
- kujdeset për një politikë të integruar dhe përfaqësuese
- ofron qartësi, si të jashtme ashtu edhe të brendshme
- krijon një bazë për organizimin bashkiak
- përforcon imazhin e bashkisë
- i vë theksin identitetit të bashkisë karshi rrethinave të saj
- krijon një bazë për qytetarët, ndërmarrjet dhe organizatat shoqërore

Si të hartojmë një vizion?

Në hartimin e një vizioni duhen shquar tre aspekte themelore.

- së pari, procesi
- së dyti, përpunimi i vetë vizionit
- së treti, komunikimi që është mjaft i rëndësishëm

a. Në lidhje me procesin

Është mjaft e rëndësishme të menaxhohet procesi në të gjithë përbërësit e tij e konkretisht, pjesëmarrja qytetare, renditja e veprimtarive, procedurat ligjore, mënyra e vendim-marrjes dhe vënia në jetë. Të gjitha këto elemente duhen siguruar. Veçanërisht vendim-marrja duhet kryer hap pas hapi dhe vënia në jetë duhet të përputhet krejt me miratimin e vizionit.

Ka mjaft rëndësi të sigurohet mbështetje e mjaftë dhe bazë për qeverinë vendore në organizimin e procesit, nisjen e debateve, bashkërendimin e veprimtarive dhe menaxhimin e projektit gjatë rrugës për në vendimin përfundimtar të Këshillit Bashkiak.

b. Në lidhje me vizionin

Vizioni thotë diçka për gjithçka.

Gjatë hartimit të një vizioni duhen gatitur skenare dhe/ose alternativa pasi vetëm atëherë zgjidhjet e qarta bëhen të dukshme dhe diskutimet gjatë debateve do të jenë më të gjalla.

Duhet një ekip shumë disiplinësh për të kryer dhe përkthyer të gjitha përfytesat dhe rezultatet e debateve në propozime konkrete për zhvillimet e ardhshme mbi të cilat do të ngrihet vizioni. Ky ekip shpërndan gjithë mbështetjen e nevojshme gjatë hartimit të vizionit, skicimin e një programi zbatimi dhe metodën e vënies në jetë në strukturë.

c. Në lidhje me komunikimin

Hartimi i një vizioni duhet bërë përmes një procesi ndërveprues. Kjo nënkupton diskutime dhe debate me të gjithë ata njerëz që kanë interesa dhe ata që janë të interesuar për këto tema. Debatet duhet të kryhen në një atmosferë frymëzuese dhe krijuese. Gjithashtu nuk duhen harruar aspektet formale të komunikimit dhe pjesëmarrjes. Për këtë arsye ato duhet të sillen në vëmendje të çdo pjesëmarrësi në proces.

Procesi i hartimit të një vizioni nis duke menduar për një slogan të mirë për qytetin (ose fshatin), dhe që mbulon drejtimin e kërkuar të zhvillimit urban. Deklarata e misionit duhet të shfaqë drejtimin e zhvillimit dhe duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur, duke filluar me emrin e qytetit. Për Peshkopinë slogani vijues u zgjodh pas diskutimit në grupin e pjesëmarrjes qytetare:

“Peshkopia, qytet miqësor e i pastër, i shëndetshëm e i kamur”.

Kjo deklaratë misioni shpreh drejtimin e bërjes së një qyteti me qytetarë miqësorë dhe një qyteti të pastër që nuk është i ndotur nga ndonjë gjë por i shëndetshëm për atë që jeton aty. Në këndvështrimin ekonomik deklarata shpreh dëshirën për t’u bërë një vend i kamur me rezerva të përshtatshme për të gjithë.

Në “skemën e ardhshme të zhvillimit urban” tregohet në ç’mënyrë mund të përpunohet një vizion urban.

Ka gjithmonë tre pika të rëndësishme nisjeje:

- Numri i popullatës për të cilën duhet të ofrohet strehim nga bashkia
- Numri i fuqisë punëtore të cilëve u duhen krijuar vend pune
- Marrëdhënia mes qytetit dhe natyrës (zonat e zëna dhe zonat e pazhvilluara)

Nga këto pika nisjeje duhen përpunuar një vizion urban dhe një vizion shoqëror që duhen menaxhuar nëpërmjet një politike qeverisëse dhe menaxhuese dhe përmes komunikimit të mirë mes bashkisë e qytetarëve.

Përsa i përket vizionit urban ka katër çështje kryesore që duhen mbaruar dhe që duhen lidhur përmes çështjes qendrore të ekologjisë dhe qëndrueshmërisë. Kjo nënkupton që çdo zhvillim i ri duhet të ketë në vëmendje këtë çështje.

E njëjta mënyrë të menduari vlen për vizionin e strukturës shoqërore të qytetit. Këtu ka gjithashtu katër çështje kryesore që duhet të lidhen përmes çështjes qendrore të kohezionit dhe solidaritetit shoqëror.

Është e rëndësishme të lidhen ato çështje me një çështje qendrore për shkak të tërheqjes së ndërsjellë (unitetit) të nevojshme të fushave të politikës bashkiake.

Katër fushat kryesore të politikës që ndikojnë në strukturën shoqërore janë:

- Strehimi dhe cilësia e jetës
- Ekonomia vendore dhe aftësia për punësim
- Natyra, mjedisi dhe argëtimi
- Trafiku dhe transporti


Katër fushat kryesore të politikës që ndikojnë mbi strukturën shoqërore janë:

- Arsimi
- Mirëqenia e publikut
- Kultura dhe artet (vlerat historike)
- Sportet dhe koha e lirë

Në përfundim bashkia duhet të ndërtojë një vizion rreth financimit të zhvillimeve dhe si të shpenzojë buxhetet vjetore të saj.

Një çështje e rëndësishme e bashkive të Shqipërisë është se si të përballen me problemin e mbledhjes së taksave vendore. Një nga të metat kryesore është mungesa e një sistemi të regjistrimit të qytetarëve që nevojitet për çdo fushë të politikës.

SKEMA E ZHVILLIMIT URBAN



04 Faza e inventarizimit

Në mënyrë që të kemi mundësinë për të ndërtuar një vizion të duhur rreth të ardhmes urbane, ekonomike dhe shoqërore të qytetit duhen inventarizuar mjaft të dhëna. Në vijim paraqitet një listë e inventareve të nevojshme.

- **Të dhëna demografike**
 - Numri i banorëve
 - Ndarja në meshkuj e femra
 - Ndarja sipas kategorive të moshës
 - Prognozë e zhvillimit të qytetarëve
- **Të dhëna shoqërore**
 - Aspekte historike dhe kulturore
 - Jeta familjare
 - Situata shëndetësore
 - Niveli i arsimimit
 - Niveli i të ardhurave
 - Gjendja e strehimit
- **Të dhëna ekonomike**
 - Përqindja e papunësisë
 - Numri i punësimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë
 - Statistika të ekonomisë vendore
- **Situata gjeografike**
 - Lidhjet urbane
 - Peisazhi
- **Të dhëna gjeologjike**
 - Struktura e tokës
 - Speciet e tokës
- **Të dhëna sizmografike**
 - Informacion sizmografik
 - Pamje e kontureve të thyera
- **Të dhëna teknike**
 - Struktura aktuale urbane
 - Sistemi i infrastrukturës / kanalizimeve
 - Gjendja e trafikut dhe gjendja e transportit
 - Cilësia urbane

- Furnizimi me ujë dhe energji
- **Aspekte juridike urbane dhe ligji i urbanistikës**
 - Gjendja e pronave
 - Ndërtimet e paligjshme
 - Rregulloret e urbanistikës
- **Të dhëna financiare**
 - Sistemi i taksave
 - Kostot e përdorimit të energjisë
 - Statistika mbi ekonominë

05 Pjesëmarrja qytetare dhe komunikimi

Në kapitullin 02 tregohet një shembull i një strukture projekti që ka cilësitë për të hartuar një plan urban bashkiak. Avantazh i këtij lloj organizmi është angazhimi i lehtë i vendasve në proces. Në dhjetëvjeçarët e fundit në vendet e Evropës perëndimore u provua se pjesëmarrja qytetare në planifikimin urban është themelore për jetësimin e tij të suksesshëm.

Komunikimi konstant mes qeverisë vendore dhe qytetarëve për procesin e zhvillimit është mjaft i rëndësishëm. Vendimet që merren nga bashkia duhen shpjeguar. Përvoja të mëparshme kanë treguar që procesi pëson vonesa në kohë kur procesi i komunikimit nuk është organizuar mirë. Interesat e njerëzve në planifikimin urban po rriten pasi ata e dinë që planifikimi urban lidhet mjaft me rezultatet ekonomike dhe të ardhmen ekonomike.

Për këtë arsye është e pashmangshme përfshirja e qytetarëve në procesin e planifikimit urban. Në Peshkopi u bë e mundur formimi i një grupi të pjesëmarrjes qytetare (GPQ) që funksiononte i pavarur nga grupet e tjera. Ky grup pjesëmarrjeje qytetare formuloi programin e vet të kërkesave për zhvillimet e ardhshme dhe ishte një partner i mirë ngacmues për bashkinë në periudhën përgatitore të planit urbanistik.

Grupi i pjesëmarrjes qytetare përbëhej nga njerëz nga Peshkopia që përfaqësonin shtresat e popullatës së Peshkopisë.

Në grup u përzgjedhën katër burra e tre gra të moshave të ndryshme. Përpos kësaj, ata kishin njohuri dhe përvoja të ndryshme. Grupi i pjesëmarrjes qytetare u mbështet dhe u këshillua nga nëpunësi i shoqërisë civile i SNV.

Grupi i pjesëmarrjes qytetare në Peshkopi përbëhej nga:

- Një ekonomist (kryetari) – 62 vjeç / mashkull
- Drejtori i një shkolle të mesme – 58 vjeç / mashkull
- Drejtori i një shkolle fillore – 52 vjeç / femër
- Një inxhinier – 50 vjeç / mashkull
- Një jurist (afarist) – 45 vjeç / mashkull
- Një ekspert i zhvillimeve shoqërore – 32 vjeç / femër
- Një student – 18 vjeç / femër

Komunikimi mes organizmit të projektit dhe qytetarëve u drejtua përmes disa kanaleve. Së pari, u varën flamuj në rrugën kryesore, grupi i pjesëmarrjes përdori tabelat e afishimit për të informuar popullatën, u shpërnda një pyetësor që u kërkonte gjithë qytetarëve nga 12 vjeç e lart idetë dhe mendimet e tyre, dhe e fundit por jo e pavlerë, në stacionin televiziv rajonal u transmetuan rregullisht reklama televizive dhe u shfaq dy a tre herë një dokumentar rreth projektit. Në fund të procesit u organizua një seancë dëgjimi publik në pallatin e kulturës të qytetit ku publikut iu paraqit projekti i planit urbanistik. Gjatë kësaj kohe qytetarët mund të reagonin mbi rezultatet e pyetësorit dhe propozimet e bashkisë për planin urbanistik dhe rregulloret.

Ky komunikim intensiv nevojitet për të informuar vazhdimisht vendasit rreth përparimit të projektit, zgjedhjet që po bëhen dhe për të matur mbështetjen në popullatë për planet dhe zgjidhjet.

06 Pjesëmarrja me nismë-marrje

Pjesëmarrje me nismë-marrje nënkupton që qytetarët mendojnë për të ardhmen e tyre dhe i bëjnë të ditur qeverisë vendore se çfarë presin nga bashkia për të arritur këtë. Në planifikimin urban në bashki pjesëmarrja e organizuar duhet të kujdeset për një situatë në të cilën qytetarët mund të shprehën lirshëm për dëshirat e tyre.

Si edhe në Peshkopi, këshillohet bërja e një pyetësoi bazuar në sistemin e “lojës së monedhave”. Kjo lojë ofron informacionin e duhur për vizionin(et) e qytetarëve. Me këtë informacion do të jetë e mundur të bëhet një vizion i përgjithshëm urban, ekonomik dhe shoqëror për të ardhmen e qytetit. Ai vizion është baza e politikës bashkiake dhe, për shembull, mund të shndërrohet në një plan urbanistik ose në një skemë zhvillimi ekonomik ose në një program shoqëror – ekonomik dhe më vonë, në programe pune.

Para shpërndarjes së pyetësorëve qytetarët duhet të informohen mirë rreth kësaj nisme të bashkisë dhe të grupit të pjesëmarrjes qytetare. Mënyra më e mirë për të informuar njerëzit është duke transmetuar reklama televizive rregullisht përgjatë një muaji. Kjo reklamë televizive duhet të shfaqë se për çfarë bën fjalë projekti, çfarë do të thotë për qytetin dhe banorët e tij që të merren me të ardhmen.

Në shtojcën A bashkëlidhet një shpjegim i “lojës së monedhave” si dhe një shembull i pyetësorit. (Kujdes! Ky pyetësor është vetëm një shembull, në varësi të gjendjes në vend, mund të jenë më të favorshme për t’u bërë pyetje të tjera).

Pasi të jenë përpunuar të gjitha rezultatet e pyetësorëve të plotësuar sipas udhëzimit bashkëngjitur organizmi i projektit do të mund të hartojë një projekt të planit urban, të planit ekonomik ose programit shoqëror-ekonomik.

Në rastin e Peshkopisë, u hartua një plan urban, bazuar në rezultatet e pyetësorëve dhe në lojën e monedhave. Plani urban është përkthimi i një vizioni zhvillimi 25 vjeçar dhe bazohet në pritshmëritë ekonomike për dhjetëvjeçarët e ardhshëm.

07 Projekti paraprak / skicëide e projektit

Para se të nisim me fazën e hartimit të projektit duhen pasur në dorë të gjitha të dhënat e inventarizuara si dhe rezultatet e pjesëmarrjes ndërevepruese nga qytetarët si dhe kërkesat e dhëna nga autoritetet më të larta, si nivelet qendrore dhe rajonale qeverisëse. Për shembull, është mjaft e rëndësishme të sigurohemi që bashkia e ka vizatuar korrekt të ashtuquajturën vijë e verdhë.

Për më tepër është mjaft e rëndësishme pasja e mundësisë për të hyrë në informacionin e pronësisë, duke bërë të qartë në çdo stad të hershëm të procesit se ku mund të hasen probleme.

Për të skicuar duhen të dhëna të përshtatshme gjeografike. Baza më e mirë është pasja në dispozicion (Autocad) e një sistemi informimi gjeografik (GIS). Kur nuk është e mundur, projekti për planin urban mund të bëhet në një hartë. Shkalla më e mirë e skicimit është 1 : 2.500.

Kjo shkallë skicimi bën të mundur që çdokush të njohë situatat aktuale dhe vendore.

Skicimi duhet të bëhet nga personeli i bashkisë që përfaqëson bashkinë në grupin e projektit ose në nëngrupet mbështetëse. Kryesisht kjo punë do të bëhet nga departamenti i urbanistikës kur ai të ketë kapacitetet e mjaftueshme. Nëse jo, kjo punë mund të bëhet nëpërmjet kontraktimit nga bashkia të një agjencie këshilluese.

Pak a shumë në të njëjtën kohë që projekti i planit urban është në skicim e sipër, mund të bëhet publikimi i parë i rregulloreve të urbanistikës dhe të ndërtimit. Këto rregullore duhet t'i bashkëngjiten planit dhe i përkasin planit urbanistik.

Me mbarimin e fazës së skicimit të projektit, projekti i planit urban bëhet objekt diskutimi dhe komenti nga qytetarët që marrin pjesë në proces. Bashkia duhet të organizojë fazën tjetër të pjesëmarrjes duke shpallur procedurën e pjesëmarrjes.

08 Pjesëmarrje ndërvepruese

Faza e parë e pjesëmarrjes qytetare duhet të ndodhë në një mënyrë ndërvepruese. Projekti i planit urban duhet të njoftohet nga bashkia ku të shpjegohet kuptimi i planit dhe procedura e mëparshme. Njoftimet mund të bëhen përmes gjithë kanaleve të mundshme si flamuj në rrugë, njoftime publike në afishe, gazeta, reklama televizive e të tjera.

Një sugjerim i mirë do të ishte hapja e një kutie të veçantë postare për bashkinë për njëfarë kohe, gjatë së cilës, qytetarët mund të dërgojnë ose të hedhin komentet e tyre për projektin e planit urban. Veç këtyre këshillohet të mbyllet periudha e pjesëmarrjes ndërvepruese duke organizuar një seancë dëgjimi publik. Në këtë seancë dëgjimi çdo qytetar mund të vijë, të marrë pjesë, të pyesë, të komentojë, të diskutojë, të paraqesë kundërshtime dhe t'u bëjë të ditur përfaqësuesve të bashkisë se çfarë mendimi kanë rreth propozimeve të projektit të planit urban.

Pas marrjes së të gjitha pyetjeve, komenteve dhe kundërshtimeve, grupi i projektit dhe nëngrupet duhet të hartojnë një listë rekomandimesh për Këshillin Bashkiak në mënyrë që të kenë një vendim qeveritar rreth ndryshimeve në projektin e planit urban, duke përfshirë rregulloret e përshkruara.

09 Skica përfundimtare dhe përkshkrimi i rregulloreve

Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak të rekomandimeve të treguara në kapitullin e mëparshëm, organizata e projektit është e veshur me tagrën për të bërë projektin përfundimtar të planit urban dhe përkshkrimet përfundimtare të rregulloreve (të ndërtimit).

Këshillohet që kjo fazë e fundit të bëhet nga stafi bashkiak në bashkëpunim me disa anëtarë të grupit të pjesëmarrjes qytetare për të shmangur keqkuptime në këtë hap të fundit të përgatitjes së planit urban dhe rregulloreve urbane.

Rezultati përfundimtar duhet miratuar nga Grupi Drejtues sikurse ky grup bëri edhe në fazat e mëparshme të projektit dhe t'ia dërgojë atë më pas Këshillit Bashkiak për miratim para se plani t'u paraqitet qytetarëve.


10 Pjesëmarrja formale (ligjore)

Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak të planit përfundimtar urbanistik (duke përfshirë rregulloret urbanistike dhe të ndërtimit), lypset një periudhë shqyrtimi dy javore që njoftohet zyrtarisht nga bashkia. Gjatë kësaj periudhe të gjithë qytetarëve u lejohet të paraqesin kundërshtime zyrtare kundër planit urban të paraqitur dhe rregulloreve urbanistike dhe të ndërtimit.

Të gjitha objeksionet e paraqitura gjatë kësaj periudhe dhe para kohës zyrtare të mbylljes do të vlerësohen nga organizmi i projektit. Këto vlerësime gjykohen nga Grupi Drejtues.

Këshilli Bashkiak duhet të vendosë për këto gjykime. Plani urbanistik duhet të përshtatet sipas këtyre vendimeve respektive. Pas këtyre rregullimeve plani dhe rregulloret urbanistike janë të përfunduara dhe gati për miratim të mëtejshëm nga Këshilli Rajonal për Rregullimin e Territorit dhe Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit.

11 Procedura e miratimit



Në skemën e mësipërme tregohet rruga që duhet të ndjekin në procesin e miratimit Planet Urbanistike dhe Rregulluese si dhe zgjerimet mbi > 5.000 m² dhe lejet e ndërtimit në Shqipëri.

Pas miratimit përfundimtar të një (master) plani urban nga Këshilli Bashkiak i një qyteti të Shqipërisë, plani urban ka nevojë për miratimin e Këshillit Rajonal të Rregullimit të Territorit (Qarku) pas të cilit, plani i paraqitet Këshillit Kombëtar të Rregullimit të Territorit për miratim. Pas këtij miratimi të fundëm plani urbanistik dhe rregulloret bashkëngjitur janë një dokument ligjor, rregullave të të cilit duhet t'i përmbahet çdo qytetar. Nëse çdokush shkel këto rregulla ai ose ajo ndëshkohet.

Plani urbanistik përfundimtar dhe rregulloret (e ndërtimit) bashkëngjitur i paraqiten publikut (për shembull në mjediset e bashkisë), kështu që sekush ka mundësi të njihet me atë që lejohet dhe atë që ndalohet.

12 Përmbledhje

Në këtë përmbledhje, tregohet tërë procesi i planifikimit në **10 hapa**.

Hapi 01

Organizimi

- Ngritja e një strukture projekti
- Bërja e marrëveshjeve midis menaxherit të projektit dhe Kryetarit të Bashkisë rreth mënyrave të komunikimit dhe vendim-marrjes për stade të ndryshme të projektit.

Hapi 02

Hartimi i një vizioni shoqëror, ekonomik dhe urban

- Hartimi i një deklaratë / slogani të misionit
- Përcaktimi i pikave qendrore për zhvillimin shoqëror dhe urban
- Përpunimi i katër çështjeve kryesore për zhvillimin shoqëror dhe urban

Hapi 03

Faza e inventarizimit

- Të dhëna demografike
- Të dhëna sociale
- Të dhëna ekonomike
- Situata gjeografike
- Të dhëna gjeologjike
- Të dhëna sizmografike
- Të dhëna teknike
- Aspekte juridike urbane dhe ligji i urbanistikës
- Të dhëna financiare

Hapi 04

Pjesëmarrja e qytetarëve dhe komunikimi

- Përbërja e një grupi pjesëmarrjeje
- Planifikimi i komunikimit me popullatën

Hapi 05

Pjesëmarrja nismë-marrëse

- Hartimi i një pyetësi të bazuar në "lojën e monedhave" për të hulumtuar idetë, opinionet dhe interesat në popullatë.
- Analizimi i rezultateve të pyetësorit

Hapi 06

Projekti paraprak / skicëide e projektit

- Me bashkimin e të dhënave të inventarizuara, të rezultateve të pyetësorit dhe të të dhënave profesionale dhe vizioneve mund të hartohet një projekt i parë i planit urban.
- Publikimi i variantit të papërpunuar të rregulloreve (të ndërtimit).

Hapi 07

Pjesëmarrja ndërvepruese

- Hapja e një kutie të veçantë postare për bashkinë për njëfarë kohe gjatë së cilës qytetarët mund të dërgojnë ose të hedhin vetë komentet e tyre mbi projektin e planit urban.
- Organizimi i një seance dëgjimi publik.

Hapi 08

Hartimi përfundimtar dhe përshkrimi i rregulloreve

- Bazuar në projektin e parë duhet të shtohen komentet dhe sugjerimet dhe të bëhet e mundur hartimi i krejt projektit përfundimtar.
- Në varësi të komenteve dhe sugjerimeve duhen rregulluar edhe rregulloret.

Hapi 09

Pjesëmarrja formale (ligjore)

- Paraqitja e modelit përfundimtar të planit urban, duke përfshirë rregulloret për një shqyrtim të fundit nga qytetarët gjatë një periudhe dy javore.
- Kjo periudhë shpallet zyrtarisht nga bashkia.
- Vlerësimi i të gjitha komenteve dhe objeksioneve që janë sjellë gjatë kësaj periudhe dhe para kohës zyrtare të mbylljes.
- Gjykimi i vlerësimit dhe paraqitja e këtyre gjykimeve tek Këshilli Bashkiak. Këshilli Bashkiak duhet të vendosë mbi këto gjykime.
- Përshtatja e planit urban me vendimet përkatëse qeveritare. Pas këtyre rregullimeve plani urban dhe rregulloret janë përfunduar dhe të gatshme për miratim të mëtejshëm nga Këshilli Rajonal për Rregullimin e Territorit dhe Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit.

Hapi 10

Procedura e miratimit

- Paraqitja e planit urban tek Këshilli Rajonal për Rregullimin e Territorit (Qarku).
- Pas atij miratimi plani urban duhet të paraqitet për miratim tek Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit.
- Pas këtij miratimi përfundimtar plani urban ka status ligjor.

Shtojca A

Shpjegimi i lojës së monedhave

Loja e monedhave luhet për të mbledhur informadon të rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve shoqërore, ekonomike dhe urbanistike. Nëpërmjet kësaj loje informacioni mund të renditet për ta bërë vendim-marrjen më të lehtë. Loja luhet shpesh në projekte ku pjesëmarrja e qytetarëve është kyçe. Përveç kësaj ajo mund të luhet në grupe të vogla dhe grupe të mëdha. Çdo pjesëmarrës merr një listë me një numër të caktuar çështjesh dhe pikash të rëndësishme që i përkasin një problemi që duhet të zgjidhet. Në këtë rast ne duam të dimë se çfarë mendojnë qytetarët në lidhje me zhvillimin e dëshiruar të qytetit të tyre. Meqenëse është e pamundur që të gjitha nevojat dhe përparësitë e njerëzve të realizohen brenda një periudhe të shkurtër kohe, duhen bërë zgjedhje.

Rregullat e lojës së monedhave

Loja e monedhave luhet nga çdokush që është 12 a më shumë vjeç dhe është anonim. Gjithsesi, pjesëmarrësit duhet të plotësojnë disa pyetje rreth jetës së tyre për t'i lejuar menaxhuesve të projektit që nga rezultatet e lojës të bëjnë interpretime dhe përfundime të pranuar shkencërisht. Rezultatet e këtij kërkimi përdoren vetëm për qëllime të një projekti planifikimi urban dhe ekonomik. Pas përmbushjes së projektit të gjitha rezultatet do të shkatërrohen.

Çdo pjesëmarrës merr një buxhet me njëfarë vlere që përbëhet nga 5 monedha. Të pesë monedhat kanë një vlerë të barabartë. Në këtë rast në një listë vendosen 19 çështje dhe pika të rëndësishme. Kjo listë shpërndahet mes gjithë qytetarëve të qytetit. Çdo pjesëmarrës mund të shtojë jo më shumë se një pikë tek numri 20 që nuk përmendet në listë. Çdo pjesëmarrës duhet ta vendosë buxhetin e tij/saj prej 5 monedhash në listën e çështjeve dhe pikave. Lejohet që të vendosen të 5 monedhat në një pikë apo çështje nëse vendosni që ta harxhoni tërë buxhetin në një zë. Por në atë rast, duhet të kuptoni që nuk do mund të shpenzoni asnjë kacidhe për ndonjë pikë tjetër. Nuk lejohet ndarja e një monedhe në dy gjysma apo në ndonjë ndarje tjetër.

Duke shënuar të gjitha shenjat e qytetarëve bëhet e mundur tërheqja e përfundimeve shkencore rreth nevojave dhe përparësive të grupeve të pjesëmarrësve. Këto përfundime mund të përdoren si bazë për zhvillimin urban dhe ekonomik të qytetit.

Çfarë duhet bërë në fund?

A) Përsa i përket listës mbi zhvillimin ekonomik:

01. Kontrolloni nëse e keni plotësuar pyetësorin për informacionin vetjak.

Kontrolloni nëse shënuat pesë në listën e "Lojës së Monedhave", pasi nuk lejohet shenjimi i më shumë se 5 prej tyre në tërë listën.

B) Përsa i përket listës së planit urban

02. Kontrolloni nëse shenjuat një për çdo pyetje.

03. Vëreni formularin në një zarf dhe kthejeni brenda – *vini datën* – në *- vini vendin*

04. Vërinë të dy formularët në një zarf dhe kthejini ato para – *vini datën* – në: *vini vendin ...*

Informacion mbi pjesëmarrësin

(Përgjigjuni duke shenjuar O përkatës blu ose të zi kështu)

- Unë jam
 - femër
 - mashkull

- Jam i moshës nga
 - 12 - 16 vjeç
 - 17 - 24 vjeç
 - 25 - 34 vjeç
 - 35 - 49 vjeç
 - 50 - 64 vjeç
 - 65 vjeç ose më shumë

- Arsimi im është
 - pa arsim
 - shkollë fillore
 - shkollë 8 - vjeçare
 - shkollë profesionale
 - universitet

- Familja ime përbëhet nga
 - një njeri
 - dy vetë
 - familje me ____ fëmijë

- Kam fëmijë në shtëpi më të rinj se 12 vjeç
 - pa fëmijë
 - 1 fëmijë
 - 2 fëmijë
 - 3 fëmijë
 - 4 fëmijë
 - më shumë se 4 fëmijë

- Unë jetoj në lagjen
 - emri i lagjes
 - emri i lagjes
 - emri i lagjes
 - emri i lagjes
 - gjetiu

- Unë jam
 - në shkollë
 - i papunë
 - i punësuar
 - puna ime e tanishme është

- E ardhura ime/jonë vjetore
(të plotësohet vetëm nga njerëz 17 vjeç e lart)
 - më pak se 170.000 Lekë
 - 170.000 dhe 420.000 Lekë
 - më shumë se 420.000 Lekë

Numri i rotacionit:
Të plotësohet nga organizata

Loja e Monedhave (20/5)

Renditni nevojat dhe dëshirat tuaja duke shenjuar çështje dhe pika vijuese me jo më shumë se 5 monedha. Sa më shumë monedha vendosni në një çështje a pikë më shumë rëndësi merr kjo çështje apo pikë nga ju.

Shembull: Ju shenjoni pikën 01 me 2 monedha dhe pikën 06 me 3 monedha. Kjo do të thotë që ju doni të zhvilloni çështjet 01 dhe 06 dhe që e gjeni çështjen 06 më të rëndësishme 01.

Ju nuk thatë që pikat e tjera nuk ishin të parëndësishme por ju zgjodhët të zhvilloni dy pikat e shenjura. Me fjalë të tjera: Ju i renditët dëshirat tuaja!

Tashmë jeni gati të merrni pjesë.

Ju keni 5 monedha të cilat kanë të njëjtën vlerë. Përfytyroni që keni tagrën të merrni vendime mbi zhvillimin e qytetit tuaj dhe mund të vendosni për shpenzimin e buxhetit. Në cilat çështje dhe pika do t'i shpenzonit buxhetet e disponueshme? Shenjoni O pas zgjedhjes suaj duke e ngjyrosur me blu ose të zezë. Një O e ngjyrosur është një monedhë.

(Përgjigjuni duke shenjuar O përkatëse blu ose të zezë si )

<i>Prioritetet e mia janë :</i>	<i>monedhat</i>
01. zhvillimi i zonave të reja të banimit	O O O O O
02. garantimi i furnizimit me ujë dhe energji	O O O O O
03. krijimi i vendeve të punës dhe punësimit	O O O O O
04. riparimi i sistemit të kanalizimit	O O O O O
05. përmirësimi i sistemit të telekomit	O O O O O
06. ndërtimi i një fushe depozitimi mbeturinash	O O O O O
07. organizimi i një sistemi të mbledhjes së mbeturinave dhe pastrimit të qytetit	O O O O O
08. përmirësimi i shërbimit shëndetësor	O O O O O
09. përmirësimi i teatrit	O O O O O
10. përmirësimi i lehtësirave në arsim	O O O O O
11. riparimi i rrugëve	O O O O O
12. ruajtja e qendrave monumentale	O O O O O
13. investimi në lehtësira kulturore	O O O O O
14. ndërtimi i parkimeve për mikrobuse	O O O O O
15. rivendosja e tregut të hapur	O O O O O
16. realizim i hapësirave të gjelbra dhe parqeve	O O O O O
17. ndërtimi i këndeve të lojrave për fëmijë	O O O O O
18. përmirësim lehtësirash sportive dhe argëtimi	O O O O O
19. heqja e të gjitha ndërtimeve të paligjshme	O O O O O
20.	O O O O O

Numri i rotacionit: Të plotësohet nga organizata

Plan Urban për (emri i qytetit)

(F/up-list)


01. A jeni dakort me idenë e ndërtimit të një unaze rreth qytetit? po
 jo
02. A jeni dakort me idenë e mbylljes së pjesës së brendshme të qytetit nga trafiku i mjeteve nga ora 10.00 – 20.00 çdo ditë? po
 jo
03. Ku preferoni të ndërtoni shtëpi të reja ose zona banimi? emri i zonës
 emri i zonës
 emri i zonës
 emri i zonës
04. A jeni dakort me idenë e rindërtimit të (emri i zonës) në një park të madh me lehtësira argëtimi për fëmijë në një mjedis të gjelbër? po
 jo
05. A jeni dakort të caktohet (emri i zonës) si lagje historike në të cilën nuk do të lejohet më të ndërtohet pa respektuar rregullore të rrepta ndërtimi? po
 jo
06. A jeni dakort me idenë e heqjes së të gjitha ngrehinave të paligjshme në qytet? po
 jo
07. A jeni dakort me idenë e ngritjes së tregut të hapur (Pazari) në (emri i zonës)? po
 jo
08. a) A jeni dakort me idenë e ndërtimit të rrugës për në teatër çka nënkupton që nuk do të lejohet më që të ndërtohet përgjatë kësaj rruge pa respektuar rregullore të rrepta ndërtimi? po
 jo
Nëse i keni thënë **po** pyetjes 8a, atëherë plotësoni 8b.
- b) Nëse ky realizim ka nevojë për një investim të madh nga bashkia, kjo d.t.th. që pagesat vendore të taksave duhet të mbulojnë këtë investim. A jeni dakort me idenë që ju si qytetarë vendas duhet të paguani këto taksa vendore për qëllimet e ndërtimit të rrugës së teatrit? po
 jo
09. A jeni dakort me idenë që zona industriale të vendoset pranë emri i zonës
 emri i zonës
 emri i zonës
10. A jeni dakort me idenë e caktimit të fushës së mbeturinave afër kufirit jug-lindor të qytetit? po
 jo

Numri i rotacionit:
Të plotësohet nga organizata

Udhëzim për përgatitjen e formularëve të kthyer nga personat që u përgjigjën

01. Shënoni të gjitha listat me një numër rotacioni
02. Shëno të gjitha formularët që përputhen me të njëjtin numër rotacioni
03. Llogaritni të gjitha monedhat për çështjen dhe pikën përkatëse
04. Ndani rezultatet për çdo çështje dhe pikë në rezultate të dhëna nga meshkuj dhe në rezultate të dhëna nga femra
05. Nën-ndani rezultatet në kategoritë i punësuar / i papunë
06. Nën-ndani rezultatet në kategoritë sipas moshave
07. Nën-ndani rezultatet sipas zonave gjeografike

Përpunimi i pyetësorëve ndjek skemën që vijon:



Shtojca B

Plani Urban Peshkopi - 03 dhjetor 2002

